



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Përpunimin e Farmakopesë Europiane, Strasburg 22.VII.1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e protokollit të konventës (EST nr.134)”.
2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”.
3. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.
4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për zgjedhjen e zotit Besnik Dervishi Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri dhe Alban Zeneli

Të ftuar:

Ogerta Manastirliu – Ministre e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale

Narvina Sinani - Drejtore e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore

Andoneta Njehrrëna - Drejtore e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit
Rregullator

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjen që kemi në rendin e ditës. Në fakt, rendi i ditës për sot është i gjatë, kemi katër çështje. Si çështje të parë kemi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Përpunimin e Farmakopesë Europiane, Strasburg 22.VII.1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e protokollit të konventës (EST nr.134)”. Komisioni ynë në shqyrtimin e këtij projektligji është komision për dhënie mendimi dhe relatore e tij është kolegja Aurora Mara.

Të pranishme sot në komision kemi ministren e Shëndetësisë, zonjën Ogerta Manastirliu dhe stafin që e shoqëron.

Zonja Ministre, mirë se erdhët në Komisionin e Ligjeve!

Do t’ju lutesha të na bënit një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje për kolegët deputetë. Më pas fjalën do t’ia kaloj relatores dhe nëse do të ketë pyetje dhe diskutime nga kolegët, debati është i hapur.

Pa humbur kohë po jua kaloj fjalën për të na bërë prezantimin e kësaj marrëveshjeje.

Ogerta Manastirliu – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Sot ne po ju prezantojmë një projektligj, të cilin e konsiderojmë të rëndësishëm për të gjithë sistemin shëndetësor dhe në veçanti për shërbimin farmaceutik dhe barnat në Republikën e Shqipërisë. Projektligji për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Përpunimin e Farmakopesë Europiane, është një hap drejt anëtarësimit me të drejta të plota të vendit tonë në Farmakopenë Europiane, e cila është kuadri rregullator që standardizon dhe kontrollon cilësinë e barnave në vendet që kanë aderuar në këtë konventë.

Farmakopeja Europiane është një dokument ligjor i detyrueshëm për vendet anëtare të Bashkimit European, por edhe për vendet e tjera, të cilat aspirojnë të futen në Bashkimin European. Aktualisht janë 100 vende, të cilat kanë aderuar apo bëjnë pjesë në këtë organizëm, që kanë pranuar të shfrytëzojnë standardet e Farmakopesë në vendet e tyre jo vetëm për garantuar kontrollin e cilësisë së barnave, të cilat importohen, por edhe kontrollin e barnave që prodhohen në vend.

Çfarë do të sjellë aderimi i Shqipërisë në Konventën Europiane? Do të sjellë një verifikim të cilësisë së barnave që prodhohen në vend, duke filluar që nga prodhimi i produkteve të thjeshta

atyre galenike deri te prodhimi vendas i të gjitha serive, duke filluar nga tabletat, ampulat dhe deri te cilësia dhe kontrolli i barnave, të cilat importohen dhe tregtohen në tregun tonë shqiptar; rrit më shumë cilësinë e barnave, sigurinë e tyre dhe garanton që analizat që do të kryhen në Shqipëri do të jenë të standardizuara sipas metodologjive të miratuara në këtë konventë.

Është e rëndësishme të theksoj që, paralelisht, aderimi në këtë konventë uhap rrugën edhe ndryshimeve që ne do të kemi së shpejti, të cilat do t'i prezantojmë edhe në parlament për ligjin e barnave, pasi vlerësojmë që ka nevojë për përmirësim të kuadrit ligjor të ligjit të barnave, por mbi të gjitha për të përshtatur dhe për të përafruar me direktivën europiane legjislacionin tonë të barnave dhe të shërbimit farmaceutik. Përpara përafrimit të këtij legjislacioni hapi i parë është përafrimi me standardet dhe metodologjitë e kontrollit dhe të cilësisë së analizave që kryhen për barnat që nga prodhimi vendas deri te barnat që importohen në tregun tonë dhe tregohen këtu, të cilat sigurisht kanë impakt direkt në shëndetin e popullatës.

Ka shumë dyshime, është folur mjaft për cilësinë e barnave, për të cilat ende flitet sot që tregtohen në Republikën e Shqipërisë. Kanë ndodhur ndryshime cilësore me legjislacionin e ri për barnat dhe shërbimin farmaceutik, por duhet që ne të standardizojmë fushën e veprimit në raport me analizimin, kontrollin dhe cilësinë e barnave që në prodhim, kjo duhet për të stimuluar edhe biznesin vendas që prodhon barna dhe për të garantuar pa dyshim edhe eksportin e barnave, të cilat do të jenë shumë më cilësore, duke futur këtë metodologji të kontrollit që nga substancat që përdoren për të prodhuar barnat e deri te vendosja e barnave në treg.

Aderimi në këtë konventë na sjell ne në një standard më të lartë, duke iu përafruar gjithë standardit të analizave të cilësisë që kërkohet pikërisht në aderimin që ne do të realizojmë nëpërmjet kësaj konvente dhe krijon një bazë të saktë dhe standarde të metodologjisë së kontrollit që Agjencia e barnave dhe pajisjeve mjekësore do të kryejë në funksion të saj të përditshëm. Paralelisht me qeverinë shqiptare jemi duke marrë masa për ngritjen e dy laboratorëve të kontrollit të cilësisë qoftë për nga pikëpamja sasiore, qoftë nga pikëpamja cilësore e barnave që tregtohen në vendin tonë. Tashmë, ky investim ka filluar dhe në muajt e parë të vitit të ardhshëm 2020 do t'i hapin rrugë dhe shtimit të numrit të testeve dhe analizave, që do të kryhen për barnat dhe kontrollin e cilësisë, dhe, sigurisht, do të rrisin edhe sigurinë e tyre. Do të jenë dy laboratorë, fiziko-kimik dhe mikrobiologjik, të cilët janë projektuar sipas standardeve europiane, sepse farmakopeja, sigurisht, drejton standardet dhe analizimin e kontrollit të cilësisë së barnave, duke na përfshirë jo vetëm si vëzhgues në këtë organizëm, por edhe duke na aspiruar si anëtarë me të drejta të plota,

ku do të raportojmë për çdo hap që do të bëjmë në raport me sigurinë dhe cilësinë e barnave që prodhohen, tregtohen dhe ruhen në vendin tonë. Ky ishte një përshkrim i përgjithshëm. Jam e hapur për pyetje në vijim.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Zonja Mara, një përmbledhje të shkurtër të relatimit në lidhje me projekt marrëveshjen dhe pastaj kalojmë te pyetjet.

Aurora Mara – Faleminderit!

Falënderoj ministren për relatimin shumë qartë, dhe nuk besoj se është e nevojshme që të zgjatem, por do të them gjërat më kryesore.

Ashtu siç e shpjegoi edhe ministrja, sot po shqyrtojmë projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Përpunimin e Farmakopesë Europiane, Strasburg 22.VII.1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e Protokollit të Konventës nr. 134.

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe kalendarit të punimeve të Komisionit për Çështjet Ligjore sot ne shqyrtojmë këtë projektligj dhe unë do të ndalem te qëllimi, përmbajtja dhe pikat me kryesore të projektligjit.

Ky projektligj mundëson aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Farmakopesë Europiane. Anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në këtë konventë europiane do të bëjë të mundur pjesëmarrjen me të drejta të plota dhe vendimmarrje lidhur me çështjet e shëndetit publik dhe praktikën më të mira të prodhimit e të shpërndarjes së barnave.

Aderimi i Republikës së Shqipërisë në Konventën e Farmakopesë Europiane do të bëjë të mundur: promovimin, ndër të tjera, të progresit ekonomik dhe social, me përfundimin e marrëveshjeve dhe me veprime të përbashkëta në fushat ekonomike, sociale, kulturore, shkencore, ligjore, si dhe në çështjet administrative; promovimin e progresit si në fushën sociale, ashtu edhe në fushën e shëndetit publik për harmonizimin e ligjeve të tyre kombëtare në zbatim të dispozitave të konventës; marrjen e masave nga vendet anëtare në lidhje me prodhimin, qarkullimin dhe shpërndarjen e ilaçeve në Europë; harmonizimin e specifikimeve për substancat mjekësore, të cilat, në gjendjen e tyre origjinale ose në formën e preparateve farmaceutike janë me interes dhe me rëndësi të përgjithshme për popujt e Europës; nevojën për të shpejtuar hartimin e specifikimeve për numrin në rritje të substancave të reja mjekësore që shfaqen në treg; promovimin e lëvizjes së lirë të produkteve mjekësore në Europë dhe më gjerë; marrjen e masave nga prodhuesit e barnave

dhe të produkteve farmaceutike lidhur me zbatimin e standardeve të cilësisë gjatë gjithë ciklit të prodhimit, qarkullimin dhe shpërndarjes së tyre në tregjet e shteteve anëtare të kësaj konvente.

Në aspektin ligjor vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit. Personalisht, mendoj se aderimi i Shqipërisë në këtë konventë do të sjellë detyrime të reja për shtetin shqiptar në drejtim të rritjes së sigurisë dhe cilësisë së barnave që do të qarkullojnë në tregun tonë, ashtu siç e shpjegoi edhe ministrja.

Së fundi, si relatore, vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë të gjithë së bashku.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

A ka pyetje në lidhje me projektligjin?

Zoti Braho, e ka kërkuar fjalën për pyetje.

Spartak Braho – Me sa kuptova, zonja Ministre, ne nuk kemi laboratorë për të bërë analizat e kiteve farmaceutike. Unë ju dëgjova me shumë interes dhe e vlerësoj shumë pozitiv faktin që këta dy laboratorë për këto dy lloje analizash, sepse janë terma shkencore, të cilat nuk po i diskutoj, do të ngrihen së shpejti. A keni dëgjuar që në Europë dhe në botë ekziston mafia e barnave? Nuk po i përmend institucionet shqiptare, por Shqipëria ka qenë pre e barnave të ardhura nga India, nga Turqia dhe nga vende të tjera, ku ka prodhime që bëhen posaçërisht për Shqipërinë. Njerëzit nuk ankohen kot për cilësinë e barnave dhe ky është një realitet. Me këtë rast unë po bëj edhe një diskutim. Pra, ky është një vendim i domosdoshëm dhe i lavdërueshëm i qeverisë që bëhet pjesë e kësaj konvente. Përpjekjet për ngritjen e këtyre laboratorëve duhet të jenë maksimale dhe duhet të jetë një vendim suksesi në punë tuaj si ministre dhe të ministrisë suaj.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Braho!

A ka pyetje të tjera?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Ministre, për sjelljen e këtij projektligji për aderimin e Shqipërisë në Konventën e Farmakopesë Europiane!

Ky projektligj ka ardhur në kuadër të 70-vjetorit të Këshillit të Europës dhe është një veprim konkret i qeverisë për të treguar angazhimin. Cilësinë e barnave e vlerësoj shumë të domosdoshme për shkak të rëndësisë që ka për sigurinë e jetës, pse jo edhe për sigurinë kombëtare.

Në relacionin e projektligjit, konkretisht në faqen 2, një nga detyrimet që buron në këtë konventë është edhe marrja e masave nga prodhuesit e barnave dhe produkteve farmaceutike për zbatimin e standardeve të cilësisë, siç e thatë edhe ju që do të ngrihen dy laboratorë. Në vlerësimin tim, laboratorët janë të domosdoshëm dhe të rëndësishëm, madje janë të vonuar, por, nga ana tjetër, ka rëndësi ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i prodhuesve, i eksportuesve, i shpërndarësve të barnave e të tjera.

Cilat janë masat që ju keni ndërmarrë ose që prisni të ndërmerrni, me qëllim që konventa pas 3 muajve, kur realisht ky projektligj hyn në fuqi, të zbatohet dhe të kemi standarde cilësore, ashtu siç i kërkon kjo konventë.

E dyta, një nga objektivat që ka konventa dhe që neve na lind detyrimi nga aderimi, është sensibilizimi i publikut për të mos përdorur antibiotikët dhe për të zhvilluar programe, të cilat rrisin cilësinë për të parandaluar sëmundshmërinë etj. Kjo është një nga objektivat kryesore që me të drejtë i keni reflektuar në relacion. Pra, aderimi në konventë është një gjë e mirë, por nuk është e mjaftueshme dhe në këtë kuadër lind nevoja për shumë specifikime për përdorimin e barnave të reja. A keni filluar të ndërmerrni hapa konkretë për përmbushjen e këtij detyrimi, që lind nga aderimi në këtë konventë?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Po, zonja Ministre.

Ogerta Manastirliu – Aderimi në këtë konventë pa dyshim që do të sjellë përgjegjësi më të mëdha për qeverinë shqiptare dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në veçanti, pasi duhet që të rrisim në një standard më të lartë për të gjithë paketën e standardeve që në momentin e prodhimit dhe deri në kontrollin e cilësisë së barnave në treg.

Për të bërë një sqarim, sot nuk është se nuk kemi laboratorë për kontrollin e barnave, sepse ne kemi laboratorë, të cilët funksionojnë sipas standardeve të vendit tonë dhe kryejnë më shumë se 300 analiza kumulative në vit. Ne kontrollojmë të gjitha substancat për prodhimin e barnave në vend, por aderimi në këtë konventë na çon në aplikimin e standardeve europiane. Nëse sot kemi standarde vendase, të huazuara apo të adaptuara, me ratifikimin e kësaj konvente do të përdorim

metodologjitë që përdor Europa. Pra, kjo nuk do të thotë se nuk kemi kontroll analizash, sepse ne kontrollojmë dhe analizojmë barnat që janë në treg, që prodhohen në vend dhe që importohen nga vendet e tjera. Këto janë të parashikuara të gjitha në ligjin kuadër të barnave dhe shërbimit farmaceutik të vitit 2015, i cili është një ligj shumë i adaptuar dhe deri diku i përafëruar, por me standardet që parashikon konventa pa dyshim që do të përmirësojnë sigurinë dhe cilësinë e barnave në tregun tonë. Kjo është një përgjegjësi që e marrim duke përfunduar laboratorët e rinj dhe investuar në pajisje të reja, duke rritur gamën e analizave. Pra, nëse sot kemi një set analizash bazike të përcaktuara për kryerjen e analizave të barnave, me investimin e ri që jemi duke bërë ne do të zgjerojmë setin e analizave, duke u përafëruar me metodologjitë e Farmakopesë Europiane. Kjo do të thotë se, duke u përafëruar me standardet europiane, ne do të rrisim standardin e cilësisë dhe do t'i hapim rrugë ndryshimit të ligjit aktual për zbatimin e këtyre proceseve, standardeve dhe metodologjive që përcakton konventa europiane.

Për sa i përket pyetjes tjetër të zonjës Hysi, se si do ta arrijmë ndërgjegjësimin, në momentin e ratifikimit të kësaj konvente, e cila hyn në fuqi tre muaj pas miratimit, të gjithë prodhuesit vendas njihen me standardet e cilësisë dhe me metodologjitë e unifikuara, të cilat duhet të përdoren për të prodhuar barna në vend. Gjithashtu, agjencia e barnave merr përsipër që të gjitha barnat t'i analizojë nëpërmjet metodologjive të unifikuara, siç ndodh edhe në vendet europiane.

Ne kemi vendosur 1 milion euro në dispozicion për pajisjet bazë të laboratorit. Sigurisht që kemi edhe një potencial aktual, të cilin do ta shfrytëzojmë për laboratorin e barnave, por rinovimi i pajisjeve dhe standardi që kërkon Farmakopea është një standard që do të zhvillohet dhe kërkon investime në vazhdim.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti kryetar!

Urime për këtë sesion!

Sa më shumë që dëgjon ministren, aq më shumë të krijohet bindja që ky aderim duhet të ishte bërë shumë kohë më përpara, madje edhe me argumentin e fundit për aderimin e metodologjive të reja europiane për të kontrolluar barnat është vërtet shumë interesante.

Po ta shikoni relacionin me kujdes, konventa është krijuar në vitin 1964 në Strasburg dhe është përmirësuar më shumë në vitin 1992, pra 55 vjet më përpara. Dakord që ju nuk mbani përgjegjësi për 55 vjet më përpara, sepse aq nuk jeni në moshë, por le të themi se në vitin 1992

është aplikuar një metodë më e re. Pyetja që unë kam dhe që është edhe gjysmë politike, a nuk kishim mundësi që të aderim më shpejt në këtë konventë apo pritëm 70-vjetorin e Këshillit të Europës që është këtë vit?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Ministre.

Ogerta Manastirliu – Pyetja juaj është me shumë vend. Ne jemi duke përafruar të gjithë kuadrin rregullator dhe legjislativ me Bashkimin Europian dhe ka një plan të unifikuar sektorial ku fillon përafrimi i legjislacionit. Hapin e parë ne e kemi bërë në vitin 2014 me ligjin për barnat dhe shërbimin farmaceutik, i cili ka vendosur bazat për përafrimin e legjislacionit. Në Konventën e Farmakopesë nuk është se nuk kemi qenë prezent si vend, por kemi qenë vëzhgues, që do të thotë se kemi filluar të njihemi me standardet e cilësisë së tyre, me metodologjinë e tyre, kemi përthithur gradë, gradë dhe kemi dashur, të paktën në këto dy vjet të drejtimit tim në Ministrinë e Shëndetësisë, që ne ta marrim këtë përgjegjësi. Aderimi në një konventë është përgjegjësi, sepse nuk mund të shkojmë të aderojmë në një konventë pa pasur investime, pa menduar se çfarë do të ndodhë më pas, në mënyrë që të mos bëjmë thjesht ligje dhe të mos aderojmë thjesht për të aderuar, por kur t'i bëjmë ato dhe t'i përvetësojmë, ne të mundemi t'i zbatojmë dhe të marrim përgjegjësi, ndaj ky është momenti i përshtatshëm, në kuadër edhe të fokusit që ka qeveria për të siguruar që shërbimi farmaceutik, që barnat në RSH të jenë të kontrolluara, të jenë cilësore dhe të kenë investimet shoqëruese, që ta bëjnë të mundur zbatimin e kësaj konvente, apo më saktë, impenjimet dhe përgjegjësitë që na vijnë ne nga kjo konventë. Këto janë investimet në laborator, investimet në agjencinë e barnave dhe pajisjeve mjekësore, investimet që ka bërë prodhuesi vendas dhe të gjithë ato elementë, të cilët duhet të bashkërendojnë punën, që kjo përgjegjësi të merret dhe të zhvillohet sipas standardeve më të mira.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Ministre!

Urdhëroni, zoti Alimadhi!

Adriatik Alimadhi – Unë kam një problem, se kjo është një fushë që, të them të drejtën, nuk e njoh dhe nuk dua të shpreh mendime të pabazuara.

Në nenin 14 thuhet se kjo konventë do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar. A është kjo ndonjë normë juridike ndërkombëtare?

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Ministre!

Ogerta Manastirliu – Për sqarim, kjo është teknikë legislative, kur një vend aderon në një konventë, teksti i konventës është i pandryshuar, pra ne miratojmë tekstin e konventës sipas konventës që është e miratuar, kështu që kjo nuk është një çështje që i përket Shqipërisë apo periudhës. Ne shkojmë atje me kushtet e tyre.

Adriatik Alimadhi – Dakord, por mund të kishte një përshkrim, të lihet derisa të ekzistojë kjo konventë, sepse kur lihet e pacaktuar...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Shteti mund të tërhiqet në çdo kohë nga konventa.

Urdhëroni, zoti Doshi!

Tom Doshi – Zonja Ministre, sqaroj opinionin se edhe sot (të më falë kush është drejtoreshë e kontrollit të barnave), ju bazoheni te konventat europiane, te Farmakopea, por bazë e të gjithë analizave që bëhen në Shqipëri, si prodhimi vendas, ashtu edhe laborator i barnave punojnë me të njëjtin standard, siç janë farmakopetë angleze, europiane se këtu del sikur nuk bëhen analiza, sikur nuk ka pasur laborator analizash në Shqipëri.

Teknologjia në farmaceutikë ndërron për çdo vit, ashtu siç zbulohen ilaçe të reja për luftën kundër kancerit apo sëmundje të tjera, ndryshojnë edhe aparaturat, pra ju po ecni përpara për një teknologji të re më të mirë, jo se kanë munguar deri më sot, se laboratorë ka pasur edhe në kohë të komunizmit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Doshi!

Urdhëroni, zonja Ministre!

Ogerta Manastirliu – Në fjalën time unë e përmenda që ne sot kemi standarde për kontrollin e cilësisë së barnave. Ne sot kemi dhe procesojmë analiza për verifikimin e barnave që prodhohen, substancave që prodhohen barnat në tregun tonë dhe ato që importohen, por aderimi në këtë konventë e ligjëron këtë standard. Ky është ndryshimi, pra nëse ne sot kemi standarde, që, padyshim, i huazojmë nga Farmakopea Europiane, me aderimin në këtë konventë ligjërojmë këtë standard dhe e unifikojmë. Pra, nuk ka më dhe nuk do të ketë deviacione. Sigurisht, edhe kontrolli i Agjencisë së Barnave do të bëhet me standarde të ligjëruara nga FE-ja. Pra, ky është dallimi, nuk është se sot ne nuk kemi një standard cilësie, apo Shqipëria nuk ka një standard cilësie siç mund ta ketë pasur vite më parë, patjetër që ka, por kjo konventë unifikon dhe na çon drejt përafrimit të legjislacionit, praktikave, rregullave të BE-së, ku ne duam të aderojmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Diskutimet ishin shteruese, prandaj e hedhim në votim në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për përpunimin e Farmakopesë Europiane””, Strasburg 22.7. 1964, tekst i ndryshuar në përputhje me dispozitat e protokollit të konventës.

Kalojmë në shqyrtimin nën për nën.

Neni 1.

Kush është dakord?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Zonja Mara, relatorja, të bëjë gati raportin për komisionin përgjegjës e më pas ky projektligji t’i kalojë seancës plenare, sipas kalendarit të punimeve të Kuvendit.

Këtu mbarojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Zonja Ministre, ju faleminderit për prezencën në Komisionin e Ligjeve!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor me qasje programatike me shumë faza”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Damian Gjiknuri dhe Alban Zeneli

Të ftuar:

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Belinda Ikonimi – Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Tedi Bushaj – përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Enkelejda Hitaj – përfaqësuese e (DPD)

Violeta Cara – përfaqësuese e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

Jemi komision për dhënie mendimi.

Relator do të jetë kolegu Jurgys Çyrbja.

Nga Ministria e Financave kemi prezentë dy zëvendësministrat.

Kush do ta bëjë prezantimin e projekt marrëveshjes për kolegët e mi të komisionit. Më pas relatori, zoti Çyrbja dhe pyetje e përgjigje. Njëri nga dy zëvendësministrat do ta prezantojë projektligjin, vendoseni vetë se cili.

Zoti Luçi, fjala është për ju!

Erjon Luçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë shkurt, do të doja të bëja një prezantim të përgjithshëm të këtij instrumenti të ri të Bankës Botërore, që deri diku është iniciuar nga qeveria jonë, dhe vetë Kryeministri ka qenë një nga ata që ka kërkuar fillimisht ndërmarrjen e disa programeve në nivel rajonal. Kjo që po sjellim para jush, është produkti i parë, që edhe Banka Botërore arriti ta bënte në nivel rajonal.

Sfida fillestare ishte për të pesë vendet e rajonit, por duke qenë se disa prej tyre nuk arritën të përgjigjeshin në kohë, u bë në disa faza. Tri vendet që do të marrin pjesë, Shqipëria, Serbia dhe Bosnje-Hercegovina, do të jenë të parat që do të zbatojnë këtë projekt, i cili ka si qëllim kryesor përmirësimin e kohës së bërjes së tregtisë mes këtyre vendeve. Është shumë afër frymës së SEFTA-s, por me një sens shumë më praktik. Si komponent kryesor ka lehtësimin e lëvizjes ndërkufitare të mallrave, ku përfshihen instalimi i konceptit të një dritareje të vetme në pikat doganore, të njohura si *national single windows*, përmirësimi i kalimeve kufitare dhe i korridoreve tregtare të përzgjedhura në këtë projekt. Është një komponent i dytë për rritjen e efikasitetit dhe parashikueshmërisë së transportit, ku synohet të instalohet një sistem inteligjent i transportit, pikërisht për të shmangur radhët e gjata e për të bërë monitorimin e transportit në kohë reale. Po ashtu, instalimi i pajisjeve dhe zbatimi i asaj që quhet VTMS, ose Virtual Transport Management Information System, menaxhimi i transportit të integruar. Komponenti i tretë është mbështetja për menaxhimin e projektit, që duhet thënë se është mbështetur nga grante.

Thjesht këtë do të doja të theksoja, që ky është një projekt rreth 25 milionë, prej të cilave 17 milionë janë kredi me një interes afër 1 përqindëshit, domethënë shumë i favorshëm. Gati 95 % shkojnë pikërisht për blerjen e pajisjeve të komponentit 1 dhe komponentit 2, me komponentit 3 të parashikuar të mbulohet me grant. Pjesa e grantit nuk është plotësuar ende, po për momentin

jemi duke e menaxhuar ne si Ministri e Financave, në bashkëpunim me doganat dhe nëpërmjet njësisë së fondeve IPA.

Shkurtimisht, kjo ishte pikëpamja e përgjithshme. Ne jemi pak nën presionin kohor, sepse po i afrohem efektivitetit të këtij operacioni, që është miratuar në bord para dy muajsh, kështu që kemi pak javë kohë për fillimin e zbatimit.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Luçi!

Fjalën e ka zoti Çyrbja, në cilësinë e relatorit, për të bërë një përmbledhje të relativeve dhe gjetjeve si relator. Më aps pyetje e diskutime.

Jurgis Çyrbja – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor, me qasje programatike me shumë faza.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon marrjen e një kredie prej 17 milionë e 600 mijë eurosh, në mbështetje të projektit për lehtësimin e tregtisë e të transportit të Ballkanit Perëndimor, me qasje programatike me shumë faza.

Programi përfshin dy faza, që do të zbatohen në një periudhë me nga pesë vjet secila. Faza e parë mbulohet nga tri vende të Ballkanit Perëndimor: Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, të konsideruara gati për zbatim, dhe do të përfshijnë një kombinim të investimeve, asistencës teknike, reformave rregullatore dhe institucionale.

Faza e dytë e programit përfshin tri vendet e tjera të rajonit: Bosnje-Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi. Rezultate e pritshme nga realizimi i këtij projekti, që do të jenë të lidhura me objektivat e zhvillimit të tij gjatë fazës së parë, janë: reduktimi i kostove të tregtisë, rritja e eficiencës së transportit mes Shqipërisë, Maqedonisë Veriut e Serbisë. Projekti është planifikuar të implementohet gjatë periudhës 2019 – 2025.

Si përfundim, në aspektin ligjor, projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural, projektligji është në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Së fundi, u kërkoj anëtarëve të komisionit që ta votojnë këtë projektligj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Çyrbja!

Ka pyetje nga kolegët?

Me sa duket nuk ka pyetje.

Ka diskutime? Nuk ka.

Atëherë kalojmë në votimin e këtij projektligji.

Kush është dakord në parim me projektligjin?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin për lehtësimin e tregtisë dhe të transportit në Ballkanin Perëndimor, me qasje programatike me shumë faza”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen të këtij projektligji.

Neni 1. Kush është dakord?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet!

Kalojmë te neni 2.

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet edhe neni 2!

Kalojmë në votimin në tërësi të këtij projektligji.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet edhe në tërësi!

Duke qenë se jemi komision për dhënie mendimi, relatori le të bëjë gati raportin, për t'ia përcjellë komisionit përgjegjës, e më pas seancës plenare.

Zoti Luçi, zonja Ikonimi, shumë faleminderit për prezencën tuaj në komision.

Ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Mungojnë:

Damian Gjikhuri dhe Alban Zeneli

Të ftuar:

Sokol Dedja – Zëvendësministër për Europën dhe Punët e Jashtme

Gentian Xhaxhiu - Përfaqësues i Drejtorisë së Fondeve të BE-së në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ulsi Manja – Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

Është përsëri një marrëveshje. Është ratifikimi i marrëveshjes së financimit mes Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA 2, Shqipëri – Kosovë 2014 – 2020, dhe alokimet e vitit 2017.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator do të jetë kolegu Adnor Shameti.

Nga Ministria e Punëve të Jashtme kemi prezent zonjën...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zëvendësministri? Ku e kam të shkruar këtu? Cili është zëvendësministri këtu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'ka problem! Ju lutem, prezantohuni, zoti zëvendësministër.

Më falni!

Nga Ministria e Punëve të Jashtme janë: zëvendësministri, zoti Sokol Dedja dhe zoti Gentian Xhaxhiu nga Drejtoria e Fondeve të BE-së.

Zoti Dedja, mirë se keni ardhur në komision!

Ju lutem një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje për kolegët e komisionit. Më pas është relatori zoti Shameti. Në fund pyetje dhe përgjigje nga anëtarët e komisionit.

Sokol Dedja - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ratifikimi i marrëveshjes të cilën po e diskutojmë sot përcakton dhe fondet e asistencës financiare të BE-së që alokohen nga buxheti i vitit 2017 të programit për bashkëpunimin ndërkufitar Shqipëri- Kosovë. Kjo marrëveshje është nënshkruar vjet në tetor nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, ndërsa në dhjetor nga pala kosovare. Alokimet nga granti i BE-së për bashkëpunimin ndërkufitar Shqipëri-Kosovë për vitin 2017 janë 840 mijë euro. Këto janë alokimet e një viti nga një program 2014-2020 sipas ciklit buxhetor të asistencës financiare të BE-së, që do të thotë se Kuvendi ka ratifikuar tashmë alokimet e viteve 2014-2016 duke ratifikuar marrëveshjet përkatëse të financimit.

Po ndalem shumë shkurt në përshkrimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri- Kosovë. Zonat e mbuluara në Shqipëri janë qarku i Lezhës dhe ai i Kukësit, ndërsa në Kosovë rajoni ekonomik Perëndimor dhe ai Jugor.

Programi synon zhvillimin social dhe ekonomik në këto zona ndërkufitare, forcimin e bashkëpunimit duke rritur kontaktet midis administratave, operatorëve ekonomike, aktorëve të shoqërisë civile në të dyja vendet dhe në të dyja zonat ndërkufitare duke rritur shkëmbimet e eksperiencës dhe duke përmirësuar politikëbërjen publike.

Fushat ku ndërhyhet, objektivat apo në gjuhën e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar prioritetet tematike janë përcaktuar para fillimit të programit nga ne, nga Kosova dhe nga Komisioni Europian nëpërmjet një procesi të gjerë konsultimi. Këta objektiva, prioritetet tematike janë: mbrojtja e mjedisit, duke përfshirë parandalimin me sa është e mundur, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e risqeve.

Prioriteti i dytë është nxitja e turizmit, duke vlerësuar trashëgiminë kulturore dhe natyrore.

Prioriteti i tretë është investimi në rini, në arsim dhe në aftësim.

Ratifikimi i marrëveshjes nga Kuvendi do t'i hapë rrugë zbatimit të saj nëpërmjet thirrjes për projekte konkrete. Është shpallur dhe ka përfunduar deri tani kontraktimi për një thirrje të këtij programi me buxhete të viteve paraardhëse. Këtë vit është shpallur thirrja e dytë për projekte. Menaxhohet nga delegacioni i BE-së si autoritet kontraktues dhe aplikojnë të paktën dy përfitues nga të dyja vendet.

Sfidë për përfituesit shqiptarë është përthithja e suksesshme e fondeve. Rolin kryesor e kanë përfituesit potencialë ata që do të aplikojnë me projekte nën thirrjet për projekte që janë kryesisht administratat vendore dhe aktorë të shoqërisë civile. Ministria jonë për Europën dhe Punët e Jashtme si koordinatorë kombëtarë e fondeve të BE-së, i mbështet përfituesit shqiptarë në përgatitjen e projekteve, por edhe ndjek aplikimin e tyre.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti - Faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu siç edhe zëvendësministri e paraqiti në materialin para komisionit tonë, unë do të mundohem të paraqes përmbledhurazi elementet e kësaj marrëveshjeje që paraqitet për miratim në komisionin tonë. Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe KE-së për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA 2 Shqipëri - Kosovë 2014-2020. Alokimet për vitin 2017.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Doshi, unë ju dëgjova me vëmendje kur folët ju.

Programi i bashkëpunimit Shqipëri- Kosovë ka qëllim kryesor të kontribujë në zhvillimin social dhe ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin midis dy vendeve ndërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta.

Ky program mbështet shkëmbimin e eksperiencës dhe të njohurive ndërmjet përfituesve, si edhe përmirësimin e politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare rajonale dhe lokale në zonën e programit.

Programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme: mbrojtjen e mjedisit, promovimin e politikave të zbutjes dhe të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimin dhe menaxhimin e rreziqeve, inkurajimin e turizmit, trashëgiminë kulturore dhe natyrore, investimin në rini, arsim dhe aftësi.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen, ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Alokimet e vitit 2017 për këtë program financohen nga një grant i BE-së nëpërmjet instrumentit IPA me një vlerë prej 840 mijë eurosh. Të gjitha elementet e tjera i paraqiti në detaje zëvendësministri.

Ftoj të gjithë kolegët e nderuar të komisionit që ta miratojmë këtë marrëveshje.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Ka pyetje?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino - Faleminderit!

Kam një pyetje për zotin Shameti, është me natyrë juridike. Ne miratojmë alokimin e fondit të vitit 2017 840 mijë euro, për të dyja vendet, edhe për Shqipërinë, edhe për Kosovën. Unë si Shqipëri mund të përfitoj 300- 500 mijë euro, varet nga dy qarqet të Lezhës dhe të Kukësit, se sa të afta janë që të aplikojnë për projekte të caktuara. Pse duhet ta ratifikoj unë si parlament shqiptar shumën prej 840 mijë eurosh dhe të mos ratifikoj shumën që më takon mua që përfitoj? Pjesën tjetër mund ta ratifikojë pala kosovare. Nuk ia bëj pyetjen zëvendësministrit, pasi duhet ta dini ju këtë gjë më mirë.

E dyta dhe më kryesorja zoti kryetar, vetëm Ministria e Jashtme e mbulon këtë, jo ndonjë ministri e linjës? Ju thoni se këto 840 mijë janë më tepër për mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e turizmit, investime për rininë, për arsimin, pra janë të gjitha politikëbërje me fjalë, ndonjë investim konkret që të vendosësh një gurë këtu nuk ka, me sa kuptoj unë. Nuk kam ndonjë merak,

por problemi është: a duhet të vijmë të alokojmë fonde të vitit 2017 tani në vitin 2019, që vërtet çfarë kemi përfituar, ku i kemi përfituar, si i kemi përfituar në këto qarqe të caktuara apo thjesht të bëjmë rutinën tonë si parlament, që miratojmë kredinë, miratojmë alokimet e fondeve dhe le të vazhdojnë si të duan. Realisht në këtë relacion duhet të ishte e detajuar ajo çfarë kemi përfituar në nga viti 2017 dhe si i kanë përfituar këto dy qarqe, për të cilat unë nuk kam ndonjë merak që janë vetëm të këtyre dy qarqeve, sepse u takon atyre ta marrin.

Së dyti, pse duhet të ngre dorë unë për 840?! Kjo është për të dyja vendet. Kosova ka parlament, ashtu siç kemi edhe ne. Unë do të ngre dorën për atë fonde sa kam marrë. Edhe zyra e Bashkimit Europian duhet të bëjë një ndarje konkrete të saj midis Shqipërisë dhe Kosovës. Në relacion thuhet se 840 mijë janë për të dyja vendet bashkë. Prandaj ne duhet të ngremë dorën për atë lekë sa marrim dhe nuk mund ta ngremë dorën për 840, ndërkohë që mund të kemi marrë disa projekte. Ky ishte thelbi.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Fino!

Ju lutem zoti Dedja, pastaj zoti Shameti.

Sokol Dedja- Faleminderit, zoti kryetar dhe zoti Fino, për pyetjet!

Pse është e pamundur të votohet vetëm për pjesën që përfiton Shqipëria?! Sepse është e pamundur të përcaktohet paraprakisht. Ne tani po flasim për alokimin e një shume, e cila do të livrohet me projekte deri 3 vjet pas alokimit, sipas rregullave të funksionimit. Pra, shpërndarja do të ndodhë në të ardhmen, por sesi do të ndodhë shpërndarja midis përfituesve në Shqipëri dhe përfituesve në Kosovë është e pamundur të përcaktohet tani, sepse është një projekt i hapur konkurrimi, ku shpallet thirrja, konkurrojnë aktorë nga të dyja anët e kufirit, bëhet përzgjedhja nga delegacioni i Bashkimit Europian, që është autoritet kontraktues dhe vetëm atëherë fillon zbatimi. Kjo do të thotë se është e pamundur të flitet sot për përfitimet që do të vijnë nga buxheti i vitit 2017, që po miratojmë sot. Ne mund të flasim për përfitime të mëparshme që janë mbuluar me buxhete të viteve të mëparshme. Siç e përmenda, në këtë cikël buxhetor të asistencës financiare 2014-2020 ka pasur një thirrje, për të cilën ka përfunduar kontraktimi, por jo zbatimi, dhe është shpallur thirrja e dytë, ku do të përfshihet edhe buxheti i vitit 2017, për të cilën është aplikuar dhe duhet të bëhet përzgjedhja e projekteve fituese. Për të parë përfitime konkrete, rrjedhimisht duhet të shohim thirrje të ciklit financiar të mëparshëm, para vitit 2014. Një projekt i suksesshëm dhe i prekshëm që duhet ta përmend është ai i konstruksionit të pikës doganore Shishtavec-Krusheve me Kosovën, investim me vlerë 2,5 milionë euro, i cili ka bërë jo vetëm ndërtimin e pikës

doganore, por edhe ndërtimin e rrugës që lidh Shishtavecën me pikën doganore dhe ndërtimin e një kalldrëmi brenda fshatit Shishtavec, në anën tonë të kufirit, për të nxitur turizmin në këtë zonë. Është një projekt, zbatimi i të cilit ka përfunduar në maj të vitit 2018.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Dedja!

A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Nuk mora përgjigje nga relatori. Unë nuk e kërkoja përgjigjen nga zëvendësministri, sepse ky është njeri i diplomacisë, nuk mund të jetë ligjor. Ju vini sot në parlament dhe na kërkon dritën jeshile për 840 mijë euro. Kaq. Ne ratifikojmë 840 mijë euro dhe themi: “Këto lekë do t’i marrë Shqipëria dhe Kosova nëpërmjet Bashkimit Europian për këto projekte, ku do të përfitojnë dy qarqe, Lezha dhe Kukësi dhe dy rajone të Kosovës”. Nuk dua të hyj më thellë dhe të kërkoj efektivitetin e projekteve, por për këto 840 mijë euro, për të cilat ne do të votojmë, do të thuhet që i ka marrë Shqipëria nga Bashkimi Europian. Pra, Bashkimi Europian ia ka dhënë Shqipërisë për të bërë këto gjëra, por ndërkohë ai ia ka dhënë edhe Shqipërisë edhe Kosovës dhe ne nuk e dimë se sa do të jetë pjesa që na takon neve si Shqipëri për të votuar. Ti më kërkon dritën jeshile për 840 mijë, që në fakt nuk kemi marrë 840 mijë, sepse, pasi të mbarojë alokimi i fondeve dhe të bëhen projektet, mund të më rezultojë dhe të merren 500, 200 ose edhe 0, sepse mund të ketë projekte më të mira Kosova. Çfarë ndodh me këtë vendim që kemi marrë ne në parlament? Kjo ishte pyetja që unë bëra dhe nuk mora dot përgjigje. Për këtë dua t’ju kujtoj, zoti kryetar, meqenëse jeni jurist, që duhet të jemi të kujdesshëm kur të votojmë këto gjëra, sepse ne mund t’i votojmë, por problemi është se sa marrim ne si shtet. Në fund të fundit, unë duhet të jem i përgjegjshëm për atë që votoj në parlament. Unë nuk jam kundër projektit në thelb, për të cilin është ndërtuar, por sa marrim ne si Shqipëri. Këtë nuk e dimë dhe nuk ma tha as relatori, i cili është shumë i gëzuar, zoti Shameti, por as përfaqësuesit e Ministrisë së Jashtme. Prandaj, duhet të shpjegohet një gjë e tillë dhe të më mbushin mendjen mua që të votoj.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Fino!

A ka diskutime të tjera? Jo, nuk ka.

Atëherë kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord me projektligjin? Kundër nuk ka. Abstenim një.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2. Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Relatori, zoti Shameti, të bëjë gati raportin dhe t’ia përcjellë komisionit përgjegjës këtë projektligj.

Zoti Dedja, shumë faleminderit për prezencën në komision dhe ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektvendimit “Për zgjedhjen e zotit Besnik Dervishi, Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Edmond Leka, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Andi Përmeti, Ediola Braha, Alban Zeneli, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi, Elda Hoti dhe Tom Doshi.

Mungon:

Damian Gjikhuri.

Të ftuar:

Besnik Dervishi- Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ulsi Manja - Kalojmë te pika e katërt dhe e fundit e rendit të ditës. Shqyrtimi i projektvendimit të qeverisë “Për zgjedhjen e zotit Besnik Dervishi, Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator do të jetë kolegu Adnor Shameti.

Ne do të zhvillojmë sot një seancë dëgjimore me kandidaturën e propozuar nga qeveria, me të cilën besoj se jeni njohur, sepse mbi tryezën e kolegëve të komisionit është vendimi nr. 550, datë 31.07.2019, i Këshillit të Ministrave, si dhe një memo e Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve të Pavarura të Kuvendit të Shqipërisë.

Para se të vazhdojmë me seancën dëgjimore me zotin Dervishi, dua t’ju bëj më dije kolegëve të komisionit se zoti Dervishi me vendimin nr. 52, datë 24.07.2014, është emëruar në pozicionin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale, i ndryshuar”, mandati i komisionerit është 5-vjeçar dhe zotit Dervishi i ka mbaruar ky mandat në datën 24 korrik 2019 dhe, po bazuar në nenin 33, Këshilli i Ministrave, si institucioni që ka të drejtën e propozimit, në datën 12 korrik 2019 ka shpallur thirrjen publike për kandidaturat për Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në përfundim të këtij njoftimi publik, rezulton se kandidatura e vetme ka qenë ajo e zotit Besnik Dervishi. Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 550, datë 31.07.2019, i ka përcjellë Kuvendit të Shqipërisë kandidaturën e zotit Besnik Dervishi për t’i dhënë edhe një mandat të dytë në krye të këtij institucioni të pavarur.

Bazuar në nenin 111 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni i Ligjeve, brenda afateve të përcaktuara në Rregullore, bën një vlerësim të përmbushjes së kriterëve kushtetuese, ligjore dhe ato të meritës nga kandidati, zoti Dervishi, zhvillon një seancë dëgjimore, që ne e kemi njoftuar për sot, dhe në përfundim voton nëse kandidati i përmbush kriteret kushtetuese, ligjore dhe ato të meritës për të qenë në krye të këtij institucioni. Sipas memos që kemi mbi tryezë, zoti Dervishi, meqenëse e ka mandat të dytë, i plotëson kriteret e nenit 35, pra kriteret për t’u zgjedhur. Po ashtu, dokumentacioni shoqëruar i Këshillit të Ministrave, që shoqëron këtë propozim, është i plotë.

Neve nuk na mbetet gjë tjetër veçse t’i japim mundësinë zotit Dervishi në këtë seancë dëgjimore të shpalosë shkurtimisht objektivat e tij; pse e kërkon këtë mandat të dytë; çfarë ka bërë

dhe çfarë i ka mbetur pa bërë që kërkon një mandat të dytë në krye të këtij institucioni, i cili, me sa duket, sivjet ka edhe një konferencë të rëndësishme ndërkombëtare për të zhvilluar.

Fjala për ju zoti Dervishi.

Besnik Dervishi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, faleminderit për mundësinë që më jepni sot të paraqitem para jush në këtë seancë dëgjimore!

Shumë shkurtimisht do t'ju bëj një përmbledhje të shkurtër të asaj çfarë është realizuar në vitet e mandatit të parë dhe objektivat kryesorë, të cilët parashikohen të realizohen gjatë mandatit të dytë. Dua ta theksoj se gjatë këtyre 5 vjetëve kam qenë i pranishëm në Komisionin e Ligjeve, ku kemi diskutuar, kemi debatuar dhe ndihma juaj nuk na ka munguar asnjëherë.

Gjatë mandatit të parë Zyra e Komisionerit është konsoliduar në dy drejtime kryesore të veprimtarisë së saj. Miratimi i ligjit të ri për të drejtën e informimit në vitin 2014, që përkoi edhe me fillimin e mandatit tim të parë, i klasifikuar në 10 ligjet më të mira në botë, ka sjellë një zhvillim cilësor për ndërgjegjësimin e qytetarëve, shoqërisë civile për ushtrimin e kësaj të drejte kushtetuese, por edhe për transparencën e autoriteteve publike, ku nëpërmjet programeve të transparencës, që duhet thënë është një koncept teje i ri dhe modern, sot kemi në dispozicion të publikut një informacion pa kërkesë, si asnjëherë më parë.

Për të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale Zyra e Komisionerit është përballur gati me një rritje 10-fish të ankesave të qytetarëve ndaj kontrolluesve publikë dhe privatë. Kjo gjë tregon rritjen e ndërgjegjësimin të tyre. Edhe në këtë fushë legjislacioni dhe vendimmarrja janë të vlerësuara sipas standardeve të Bashkimit European. Në vlerësim të këtyre standardeve, Zyra e Komisionerit është pranuar anëtar vëzhgues në Bordin European të Mbrojtjes së të Dhënave dhe është zgjedhur anëtar i Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Botërore të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave.

Prioritet i punës së Zyrës së Komisionerit do të jetë transpozimi i rregullores së përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave personale të Bashkimit European (GDPR), e cila është parashikuar në PKIE-në të realizohet deri në fund të vitit 2020.

Komisioneri, në ushtrim të detyrave të tij, është shprehur me mbi 530 vendime dhe me mbi 200 rekomandime apo akte të tjera, të cilat, në vlerësim të publikut, operatorëve të fushës përkatëse, shoqërisë civile, ekspertëve dhe akademikëve, kanë ndikuar dhe kanë zhvilluar

ndjeshëm jurisprudencën e dy të drejtave kushtetuese: të drejtën për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Duke ju garantuar për standardet dhe vijimin e reformave integruese në të dyja fushat kryesore të veprimtarisë së institucionit, kërkoj mbështetjen tuaj për të miratuar propozimin e Këshillit të Ministrave për të vijuar në detyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në mënyrë të veçantë, dua të vlerësoj mbështetjen që Zyra e Komisionerit dhe unë, personalisht, kam pasur gjatë kësaj periudhe nga ky komision, gjë e cila kam besim të plotë se do të vazhdojë edhe në vijim. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishi!

A ka pyetje nga kolegët për zotin Dervishi?

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Dua të bëj një pyetje të singertë: dosjen e zotit Dervishi dhe punën e tij e kam ndjekur, sepse kam qenë relator dhe ka qenë një punë e jashtëzakonshme dhe shumë e mirë. Shumë mirë që qeveria na propozoi përsëri një ekspert, si zoti Dervishi, për një mandat të dytë. Për të qenë korrekt me veten time, me ty, por edhe me opozitën, ka një formulim të vetëdeklarimit për zbatimin e ligjit nr. 138 “Për garantimin e integritetit të personave që emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”. Unë e kam parë me vëmendje këtë formular që ju e keni plotësuar, sipas atyre që ju dini. Pyetja ime është konkrete: a është plotësuar në mënyrë të rregullt dhe të saktë ky formular, sepse mos na del nesër ndonjë gjë tjetër, duke qenë i vogël; je takuar, nuk je takuar me mua në Gjirokastrë; ke luajtur ose jo futboll; ke shkuar në Greqi ose jo, ke pasur një punë... A je i saktë me këtë vetëdeklarim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Na e thoni që tani, para se të merrni mandatin e dytë, se, edhe në qoftë se keni shpëtuar nga mandati i parë, pa jua kapur ata të PD-së, të mos jua kapin tani... E kupton?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtë kam.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Fjala është për ju, zoti Dervishi.

Besnik Dervishi – Ju faleminderit, zoti Fino!

Natyrisht, unë mbaj përgjegjësi të plotë qoftë morale, qoftë qytetare, por, në radhë të parë, ligjore, për atë çfarë kam deklaruar dhe kam plotësuar në formular, të cilin e kam plotësuar që me miratimin e ligjit, pasi, për shkak të detyrës, më është dashur ta plotësoj që në atë periudhë dhe gjatë gjithë kësaj periudhe është *online* dhe i aksesueshëm nga të gjithë.

Nëse më lejoni, si Komisioner i Mbrojtjes së të Dhënave Personale, natyrisht, kam të drejtën të jap autorizim edhe për shkeljen e privatësisë. Zoti Fino është dëshmitar i një periudhe të hershme dhe, natyrisht, mund të luajë një rol të rëndësishëm në këtë pikë. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishi!

Zoti Alimadhi ka një pyetje për zotin Dervishi.

Adriatik Alimadhi – Zoti Dervishi, në fakt, për shkak të eksperiencës që kemi pasur në një studio ligjore, por më shumë noterie, disa institucione të shtetit na kërkojnë të dhëna për subjekte të ndryshme. Në fakt, në një rast ne ju kemi kërkuar nëse privohen të drejtat e individit në këtë rast dhe ju, në fakt, e keni mbështetur procesin. Jam shumë dakord me këtë, por a mund të ketë një rregullim që noteri, në këtë rast që ofron një shërbim publik, pra kur e bën këtë të fundit, të jetë i mbrojtur? Sepse ai i jep të dhënat e individit në këtë rast, pavarësisht se ne kemi pasur një proces gjyqësor, të cilin e humbëm për shkak të kësaj, por deshëm të ruanim të dhënat personale të individit. Pra, a ka dhe a duhet këtu një marrëdhënie rregull – ligj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Ju lutem, zoti Dervishi, një përgjigje!

Besnik Dervishi – Jo pa qëllim është një praktikë europiane dhe botërore, tashmë e konsoliduar, që si e drejta për informim, ashtu edhe mbrojtja e të dhënave personale, që janë të dyja të drejta dhe liri themelore të njeriut, janë të përqendruara në një institucion, dhe kjo është një praktikë e gjerë. Pse është kjo? Sepse duhet që, nga njëra anë, të vlerësohet e drejta për informim, pra informacioni publik (çdo informacion që bëhet i disponueshëm, në raport me mbrojtjen e të dhënave personale, të cilat, edhe në këndvështrimin e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, vendosen së fundi në të njëjtën balancë), por, nga ana tjetër, rast pas rasti, nga ana e autoriteteve, që në rastin konkret është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në gjykimin administrativ (natyrisht çdo akt i Komisionerit mund të ankimohej në Gjykatën Administrative) bëhet në mënyrë proporcionale.

Unë jua thashë në përshkrimin tim të shkurtër që si ligji “Për të drejtën e informimit” është nga ligjet më moderne dhe, aktualisht, sot klasifikohet i gjashti në botë, sado unë thashë në dhjetëshe, por është i gjashti në botë, ashtu edhe ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, pavarësisht se është konform direktivës nr. 2546 të Bashkimit Europian, e cila është zëvendësuar me rregulloren e re, është në standardet e tij. Siç ju thashë, edhe rregullorja do të implementohet në vitin 2020, por nuk ka risi. Risitë e vetme janë risi teknologjike dhe çështjet e reja që kanë dalë për të.

Më konkretisht, ligji “Për të drejtën e informimit”, në nenin 17 të tij parashikon kufizimet dhe një nga rastet e kufizimit është mbrojtja e të dhënave personale. Gjithashtu, edhe ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” ka përjashtimet e tij dhe në germën “b” të pikës 4, të nenit 4, në mos gaboj, por nuk besoj ta gaboj, përcakton rastet e përjashtimit nga mbrojtja e të dhënave personale që kanë të bëjë me funksionet publike. Pra, vetëm në rastet kur kemi funksione publike ose në rastet kur, në mënyrë proporcionale, vlerësohet interesi publik, i cili prevalon, atëherë ato mund të bëhen publike. Në të gjitha rastet e tjera kufizohen.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Dervishi!

Nëse nuk ka pyetje të tjera nga kolegët, zoti Dervishi, shumë faleminderit për prezencën në komision në këtë seancë dëgjimore! Jeni i lirë të vazhdoni. Ditë të mbarë!

Besnik Dervishi – Faleminderit juve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Do të vazhdojmë me diskutimin lidhur me kandidaturën e zotit Dervishi dhe pastaj me votimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit! Ditë të mbarë!

Sipas nenit 111 të Rregullores, diskutimi lidhur me miratimin e kandidaturës së zotit Dervishi bëhet pa prezencën e tij.

Sipas memos që keni përpara, dosja e kandidatit është e plotë. Zoti Dervishi plotëson kriteret e nenit 35 për t’u zgjedhur, po ashtu dokumentacioni është i plotë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Dervishi ka plotësuar të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji. Në dosje përfshihet: kopje e letërnjoftimit, *Curriculum Vitae*, formulari i vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138 të vitit 2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ofrojnë funksione publike”, i ndryshuar”, formulari i aplikimit për informim në zbatim të ligjit nr. 45 të vitit 2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, si dhe dy letra rekomandimi.

Të nderuar kolegë, sipas nenit 111 të Rregullores, do të hedh në votim kandidaturën e zotit Dervishi për një mandat të dytë si Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kush është dakord me kandidaturën e zotit Dervishi? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet kandidatura e zotit Besnik Dervishi për një mandat të dytë si Komisioner për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Shameti, si relator, në bashkëpunim me Shërbimin e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura të Kuvendit, të bëjnë gati raportin dhe vendimin përkatës për Kuvendin për seancën plenare, në mënyrë që në seancën më të afërt të votohet edhe kandidatura e zotit Dervishi për të qenë në krye të këtij institucioni.

Edhe një herë, dua t'ju falënderoj, të nderuar kolegë, për mbledhjen e sotme dhe për angazhimin tuaj në diskutimin e çështjeve që kishim në rendin e ditës, po ashtu edhe këshilltarët e Kuvendit dhe Shërbimin e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura për kontributin në mbarëvajtjen e mbledhjes së sotme!

Shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!

Mbledhja e radhës, së bashku me rendin e ditës, do t'ju njoftohet nëpërmjet sekretarisë së komisionit.

MBYLLET MBLEDHJA